



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVES
VRHOVNI SUD KOSOVA– SUPREME COURT OF KOSOVO

GJS-2023-005

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 par.1, nenpar.1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala P.B., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren – Sh.E., me datë 14.03.2023, merr këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga pala P.B., ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren- Sh.E..

Arsyetim

Pala P.B., nga Prizreni, me 06.02.2023, ka paraqitur ankese ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren- Sh.E., të cilën ankese ia ka drejtuar autoritetit jo kompetent Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me 14.02.2023, konform nenit 9, par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve e ka përcjellë ankesën tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetares së Gjykatës Themelore të Prizrenit

Ne ankese, parashtruesi thekson se kryetarja e gjykatës ka bërë shkelje disiplinore, për të mbrojtur shkeljet ligjore të gjyqtarit S. Ç., (në kohën sa ishte gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren). Kështu, thekson se ka bërë kërkesë për rishikim të procedurës penale, ndërsa duke parë se gjykatat nuk po i shqyrtojnë provat, por po vendosin sipas dëshirës së tyre i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prizren, znj. Sh.E., që ta dërgojë në zyrën e faranikes certifikatën e regjistrimit të biznesit, me nr.70..., të cilës i janë ndërruar të dhënat nga biznesi individual në organizatë biznesi për të krijuar elementet e veprës penale nga S. Ç. Po ashtu, ka kërkuar nga prokuroria që ta dërgojë në zyrën e forenzikes certifikatën e njëjtte, dhe asnjehere nuk janë marrë për bazë kërkesat vetëm për ta dëmtuar atë, duke kërkuar që të hetohet ky rast dhe nëse gjykatat kanë bashkëpunuar në të gjitha shkallët për ta dëmtuar të ndiqen sipas detyrës zyrtare.

Duke pasur parasysh afatin kohor per ankese, ka bere ankese dhe e ka dërguar ne Gjykatën e Apelit dhe pastaj është marre me nje problem se a ka qene gjyqtarja V.B., anëtare e kolegjit duke qene se ajo ka qene kandidate ne auto-shkollën e tij. Pas marrjes se informacionit se ajo nuk ka qene ne kolegji eshte takuar me kryetaren e Gjykatës Sh.E., e cila e ka pritur me 24.08.2022 dhe i ka thene se do t'i jep përgjigje me shkrim. Pastaj, eshte takuar dy here me nënkryetaren e cila i ka premtuar se do te marre përgjigje, eshte takuar edhe njehere me kryetaren me 24.01.2023 e cila i ka premtuar se do te marr përgjigje por deri me sot nuk ka marre pergjigje. Kurse, konform nenit 9 nese Kryetari ose Kryeprokurori nuk e shqyrton dhe nuk vendos per ankesen ose nuk e njofton personin qe ka bere ankese, sic ceket ne par.6, kryen shkelje disiplinore. Kërkesës ia ka bashkëngjitur; kërkesën drejtuar Këshillit date 8.11.2021, kërkesën drejtuar Kryetares se Gjykates date 21.09.2022, parashtrësën drejtuar Këshillit Gjyqësor te Kosovës date 31.12.2021, procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor date 5.12.2016, vendimin e Gjykatës Themelore ne Prizren PK.nr.88/2022 date 1.07.2022, me te cilin është hudh kërkesa per rishikim, ankesa e bere ndaj këtij vendimi, njoftimi i Prokurorit te Prokurorisë Themelore ne Prizren.

Me qellim te vërtetimit te bazës se arsyeshme siç kërkohet me ligj, te pretendimeve te lartcekura si autoritet kompetent kam kërkuar nga gjyqtarja te deklarohet lidhur me kete rast dhe kam pranuar deklaratën e te njëjtës.

Kryetarja e gjykatës ne deklaratën e saj thekson se, ne Gjykatën e Prizrenit ndaj ankuesit është zhvilluar procedure penale, ku me aktgjykimin P.nr.206/2015 date 07.12.2016, eshte shpallur fajtor dhe dënuar me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 7 muaj, dhe ky aktgjykim ka marre forme te prere me 15.09.2017. Ndaj këtyre vendimeve ankuesi ka paraqitur kërkesë per rishikim te procedurës penale, ku kolegji shqyrtues i përberë nga Sh.E., kjo si kryetare, R.E. dhe V.B., anetare, me aktvendimin PK.nr.88/2022 e dates 01.07.2022, e kane hedh kerkesen per rishikim te procedures penale si te pabazuar. Me aktvendimin e Gjykates se Apelit te Kosoves PN.nr.913/2022 date 2.09.2022, eshte vertetuar aktvendimi i lartcekur.

Pastaj, ankuesi me 6.07.2022, kishte parashtruar kërkesë qe te dërgohet ne zyrën e Forenzikes prane Ministrisë se Brendshme, certifikata e regjistrimit te biznesit me numer:70, me emertimin auto-shkolla "G", ku me njoftimin e dates 12.07.2022, e ka njoftuar se nuk jane organ kompetent per te derguar dokumentin ne fjale tek organi i kerkuar.

Si kryetare e gjykates i ka dhene pergjigje ne te gjitha takimet e organizuara, te cilat ia ka bashkangjitur edhe kesaj deklarate, dhe eshte njoftuar se ka pas te drejte ankese ndaj aktvendimit, por ne asnje moment nuk e ka përmendur faktin se gjyqtarja V.B., eshte dashtë te përjashtohet nga vendosja ne këtë çështje. Pastaj, ne kete drejtim gjyqtarja V.B., ka theksuar se ne auto-shkollën e ankuesit ka kryer vetëm 5 ore te vozitjes sa per aftësim, por orët tjera i ka kryer ne auto-shkollën "V.", ne Suhareke, ku edhe e ka kryer provimin, dhe per rastin konkret nuk eshte përjashtuar sepse konform dispozitave ligjore nuk ka pas baze per përjashtim. Si kryetare e gjykatës ne takimet e organizuara me qytetar cdo muaj edhe me shkrim, ankuesi ne :fjale edhe përkundër ketij fakti eshte pranuar cdo muaj ne takim dhe ate me 25.07.2022, 22.08.2022, 24.10.2022, 29.11.2022, 22.12.2022 dhe 24.01.2023, ku dy nga keto takime i ka mbajtur nenkryetarja e gjykates R.E. Per shkak se ankuesi eshte problematik ne takimin e fundit nuk i eshte lejuar fare te hyj per shkak te sjelljes se tij te ashpër dhe prishjes se rendit dhe qetësisë ne gjykate. Pretendimet e tij jane

te pabaza sepse vendosja lidhur me kërkesën per rishikim eshte bere konform dispozitive ligjore. Deklaratës i ka bashkangjitur keto dokumente: kërkesën per Rishikim te Procedures Penale, paraqitur nga ankuesi; mendimin e Prokurorisë Themelore ne Prizren RLN\I.nr.55/2022; aktvendimin PK.nr.88/2022, te dates 01.07.2022; kërkesën e ankuesit per dergimin e dokumenteve ne Forenzikes; njoftimin e gjykates I.GjA.nr.1/2022-62, te dates 12.07.2022; ankesen ndaj aktvendimit; aktvendimin e Gjykates se Apelit te Kosoves PN.nr.913/2022 date 02.09.2022; përmbledhjen e procesverbaleve te takimeve me ankuesin; pergjigjen lidhur me kerkesen e parashtruar ne takime date 08.02.2023; flete dergesen se ankuesi e ka pranuar pergjigjen; shenimin zyrtar te gjyqtares V.B..

Si autoritet kompetent, pas shqyrtimit te ankeses dhe provave te bashkangjitura vleresoj se ankesa ne rastin konkret është dukshëm joserioze. Ngase, kryesisht ka te beje me procesin e vendimmarrjes se gjyqtareve te Gjykates Themelore ne Prizren, se pari, ndaj procedures penale qe eshte zhvilluar ndaj tij qe ka rezultuar me aktgjykim me te cilin është shpall fajtor dhe qe ka marre forme te prere, pastaj me vendimin qe eshte marre përkitazi me kërkesën per përsëritje te procedurës penale. Ne kete drejtim si autoritet kompetent nuk eshte ne kompetencën time te vleresoj aktgjykimet dhe aktvendimet e formes se prere, kurse pretendimet lidhur me veprimet e gjyqtareve dhe kryetares ne kete drejtim me asgje nuk i argumenton, pervec qe shpreh pakënaqësinë e tij rreth vendimmarrjes.

Pervec kesaj, bazuar ne përgjigjen qe e ka dhene kryetarja e gjykatës dhe provave te cilat ia ka bashkëngjitur deklarates del se, ajo i eshte përgjigjur te gjitha kerkesave te tij dhe ne kete drejtim krejtësisht pa baze pretendohet se eshte shkelur par.7 i nenit 9 te Ligjit per Proceduren Disiplinore te Gjyqtareve dhe Prokuroreve.

Pra, si autoritet kompetent vleresoj se nga ankesa e paraqitur nuk rezulton asnjë dyshim se kryetarja e Gjykates Themelore ne Prizren ka kryer shkelje disiplinore.

Nga arsyet e cekura me larte, e ne baze te nenit 9 par.6 te Ligjit per Përgjegjësinë Disiplinore te Gjyqtareve dhe Prokuroreve, dhe nenit 7 par.3, nenpar.3.2 te Rregullores se KGJK-se, nr.05/2019, per Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitivin e ketij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës
Supreme

1. Kopje:
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
3. Kryetares se Gjykatës Themelore ne Prizren,
4. Pales ankuese,
5. Arkivit te Gjykates Supreme.